

KONTRATË THEMELIMI E SHOQËRISË SË THJESHTË “LOGU LAW”

Sot, më datë 14.02.2024, Anëtarët Themelues të Shoqërisë së Thjeshtë:

Z. Marash Logu, i biri i Zef-it, i lindur më datë 01.03.1995, në Sermë, Shkodër dhe banues në Kamëz, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039145031 dhe nr. personal J50301104U.

Z. Shkelzen Logu, i biri i Zef-it, i lindur më datë 26.08.1991, në Sermë, Shkodër dhe banues në Kamëz, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 037428714 dhe nr. personal J10826119T.

Këtej e tutje referuar individualisht si “Pala” ose “Anëtari” dhe kolektivisht si “Palët” ose “Anëtarët” kanë rënë dakord për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “Logu Law”, veprimtaria e së cilës do të rregullohet sipas dispozitave të kësaj Kontrate, Statutit të Shoqërisë dhe neneve 1074 – 1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë është “Logu Law”.
- 1.2 Shoqëria themelohet dhe funksionon si një shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat e neneve 1074 – 1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 1.3 Shoqëria e thjeshtë është person juridik privat.

NENI 2

SELIA

- 2.1 Shoqëria e thjeshtë e ka selinë në adresën: Rr. Hamdi Sina, Pallati mbrapa Marketi im, Kati 6, Apt. 1, Liqeni i Thatë, Tiranë.
- 2.2 Shoqëria e thjeshtë mund të krijojë degë kudo në Shqipëri apo në vende të tjera për t'i shërbyer qëllimit të saj.

NENI 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- 3.1 Shoqëria e thjeshtë do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar kohe.
- 3.2 Veprimtaria e Shoqërisë së thjeshtë do të fillojë menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me marrëveshje të themeluesve të saj.

NENI 4
VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

- 4.1 Veprimtaria e Shoqërisë së thjeshtë bazohet në kushtet e kësaj Kontrate, Statutin e Shoqërisë, si dhe në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë së thjeshtë është i përbërë nga kontributi i Anëtarëve Themelues në vlerën 10.000 lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar është investuar nga Anëtarët Themelues në këtë mënyrë:
- Z. Marash Logu në masën 90% të vlerës së kapitalit themeltar.
 - Z. Shkelzen Logu në masën 10% të vlerës së kapitalit themeltar.
- 5.3 Me regjistrimin e Shoqërisë së thjeshtë, kjo shumë do të depozitohet në llogarinë bankare të shoqërisë së re.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË DHE FITIMI I REALIZUAR

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- 6.1 Shoqëria e thjeshtë do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:
- Këshillim ligjor të personave fizikë dhe juridikë;
 - Përfaqësim gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqimit, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
 - Hartimi i akteve ligjore, kontratave, kërkesëpadive, ankimeve, rekurseve, kërkesave për persona fizikë dhe juridikë;
 - Konsulencë imobiliare, shitje, blerje, dhënie me qira, ndërmjetësim të pasurive të paluajtshme;
 - Çdo veprim tjetër financiar dhe tregtar që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7
FITIMI I SHOQËRISË

- 7.1 Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis Anëtarëve themelues në përqindje proporcionale me kontributin bazë të tyre, konkretisht, Z. Marash Logu do të përfitojë 90% të fitimit dhe

Z. Shkelzen Logu do të përfitojë 10% të fitimit të realizuar gjatë vitit ushtrimor në bazë të pasqyrave financiare vjetore.

7.2 Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

III. ANËTARËT THEMELUES, ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

NENI 8

DETYRIMET E ANËTARËVE THEMELUES

8.1 Anëtarët Themelues kanë këto detyrime:

- Të regjistrojnë Shoqërinë e thjeshtë pranë të gjitha institucioneve shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore, duke shlyer rregullisht edhe detyrimet përkatëse;
- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë;
- Të sigurojnë mjediset dhe infrastrukturën e nevojshme për fillimin e aktivitetit;
- Të sigurojnë mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë së thjeshtë dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore.

NENI 9

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

9.1 Organet drejtuese të Shoqërisë së Thjeshtë janë:

- Asambleja e Anëtarëve
- Administratori i Shoqërisë

9.2 Administrator i parë i Shoqërisë është Z. Marash Logu, shtetas shqiptar, lindur në Shkodër, më 01.03.1995, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 039145031.

9.3 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre përcaktohet në Statutin e Shoqërisë së thjeshtë.

NENI 10

KONFIDENCIALITETI DHE PËRGJEGJËSIA

10.1 Anëtarët Themelues si dhe të gjithë Anëtarët që do të pranohen si të tillë, duke përfshirë dhe bashkëpunëtorët e Shoqërisë, detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë.

10.2 Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e Shoqërisë së Thjeshtë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

IV. DISPOZITA TË NDRYSHME

NENI 11

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 11.1 Çdo mosmarrëveshje midis Shoqërisë dhe Anëtarëve Themelues, ose mes Anëtarëve Themelues dhe trashëgimtarit, ose ndërmjet tyre dhe/ose Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve. Nëse një zgjidhje e tillë dështon, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.


NENI 12

DISPOZITA TË FUNDIT

- 12.1 Kontrata u hartua në bazë të vullnetit të lirë të Anëtarëve Themelues, në përputhje me parashikimet përkatëse të Kodit Civil, në tre kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua, u kuptua dhe u pranua dhe u nënshkrua nga Anëtarët Themelues në datën e sipërpërmendur.

ANËTARËT THEMELUES

Z. Marash LOGU



Z. Shkelzen LOGU

